

VENDIM
Nr.383, datë 19.5.2010

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE TË SHPËRNDARJES SË FONDIT TË
KOMPENSIMIT NË VLERË PËR PRONARËT E PASURIVE TË PALUAJTSHME,
PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMET INFORMALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6 e 8 të ligjit nr.10239, datë 25.2.2010 “Për krijimin e fondit special të kompensimit të pronave”, të nenit 15/1 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (në vijim AKKP), në zbatim të vendimeve të Këshillit të Ministrave, ku përcaktohet shpërblimi i pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale, njofton publikisht në media dhe/ose nëpërmjet faqes së vet zyrtare, listën e personave që përfitojnë nga fondi i kompensimit të pronave, për periudhën përkatëse.

2. Në njoftimin publik duhet të përcaktohen:

a) gjenealogjia e përfituesit;

b) periudha kohore e paraqitjes së kërkesës;

c) dokumentacioni i nevojshëm shoqëruar i kërkesës;

ç) vlera e tarifës së shërbimit;

d) detyrimi për subjektet përfituese për të hapur, në emër dhe për llogari të tyre, një llogari bankare në njërin nga bankat e nivelit të dytë.

3. Procesi i regjistrimit/pranimit të kërkesave për kompensim fillon 5 (pesë) ditë pas datës së njoftimit publik dhe vazhdon për 30 (tridhjetë) ditë.

4. Me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të AKKP-së ngrihet grupi i punës për pranimin e shqyrtimin e kërkesave, me objekt shpërblimin e pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale, dhe shpërndarjen e fondit përkatës.

5. Kjo procedurë kryhet për çdo fond që i kalon AKKP-së sipas ligjit nr.10239, datë 25.2.2010 “Për krijimin e fondit special të kompensimit të pronave”, dhe në zbatim të vendimeve të Këshillit të Ministrave, ku përcaktohet shpërblimi i pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale. Kompensimi bëhet në masën e përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave, ku parashikohet shpërblimi i pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale.

6. Subjekti apo përfaqësuesi me prokurë i tij, brenda afatit të përcaktuar në njoftimin publik, paraqet pranë zyrës së AKKP-së, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Kërkesën për kompensimin e pronës sipas formatit tip, bashkëlidhur këtij vendimi;

b) Dëshminë e trashëgimisë për të gjithë trashëgimtarët e ligjshëm të subjektit përfitues, sipas radhës së trashëgimtarëve, në përputhje me përcaktimet e Kodit Civil. Për dëshmitë e trashëgimive të lëshuara nga gjykata për testamentin e bërë me akt noterial të sillet certifikatë familjare e personit, për të cilin është lëshuar kjo dëshmi trashëgimie;

c) Prokurën e posaçme, të nënshkruar nga të gjitha subjektet që përfitojnë kompensim, ku si tagër i nevojshëm të jetë edhe e drejta për të tërhequr vlerën financiare, në emër të tyre;

ç) Vërtetimin e lëshuar nga banka e nivelit të dytë për hapjen e llogarisë bankare në emër dhe për llogari të subjektit përfitues, ku përcaktohet edhe numri i llogarisë bankare ku do të transferohet vlera financiare e përfituar;

d) Fotokopjen e dokumentit të identifikimit, si dhe certifikatën familjare të kërkuar;

dh) Mandatpagesën, që vërteton pagimin e tarifës së shërbimit.

7. AKKP-ja bashkëpunon me ALUIZNI-n dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme për verifikimin e konfirmimin e të dhënave për subjektet përfituese.

8. Grupi i punës, sipas pikës 4 të këtij vendimi, brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga përfundimi i afatit për paraqitjen e kërkesës për kompensimin e pronës, kryen veprimet e mëposhtme:

a) Verifikon legjitimitimin e kërkesit për çdo kërkesë për kompensimin e pronës;
b) Kontrollon dokumentacionin e paraqitur nga subjekti përfitues;
c) Konfirmon të dhëna të tjera të nevojshme pranë institucioneve përkatëse;
ç) Harton relacionin, në të cilin i propozon Drejtorit të Përgjithshëm kalimin e shumës në numrin e llogarisë bankare përkatëse;

d) Harton listën e subjekteve që kompensohen.

9. Drejtori i Përgjithshëm i AKKP-së, në përfundim të procesit të verifikimit nga grupi i punës,:

a) nxjerr vendimin për miratimin e listës së subjekteve që kompensohen, ku përcaktohet edhe numri i llogarisë bankare ku do të derdhet vlera e kompensimit;

b) urdhëron publikimin e listës së subjekteve që kompensohen;

c) njofton kërkesin, që nuk përfshihet në listën e subjekteve që kompensohen, duke përcaktuar arsyet e mospërfshirjes.

10. AKKP-ja kryen veprimet me degën e thesarit dhe bankën e nivelit të dytë për derdhjen e shumës në depozitën bankare, të hapur për këtë qëllim nga subjekti përfitues, në përputhje me procedurat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për kryerjen e pagesave nga Buxheti i Shtetit.

11. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, AKKP-ja realizon ndarjen e fondit aktual të kompensimit të pronave në vlerë proporcionale me masën përkatëse të parashikuar në listat bashkëlidhur vendimeve, të miratuara deri më tani.

12. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

KËRKESË

PËR KOMPENSIMIN E PRONËS

Drejtuar: AGJENCISË SË KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE, TIRANË

Data e paraqitjes së kërkesës: ____/____/2010

Subjekti përfitues:

Emri
Mbiemri

Atësia

Përfaqësuesi me prokurë i subjektit përfitues, që paraqet kërkesën:

Emri
Mbiemri

Atësia

Adresa e subjektit përfitues ose e përfaqësuesit të tij me prokurë:

Qarku

Qyteti

Fshati

Lagjja

Rruga

Numri i banesës

Telefon

Celular

e-mail

Në përputhje me nenin 15/1 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, neneve 5 dhe 6 të ligjit nr.10 239, datë 25.2.2010 “Për krijimin e fondit special të kompensimit të pronave”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr._____, datë_____/_____, kërkoj kompensimin e pasurisë së paluajtshme, që preket nga ndërtimet informale.

Në listën bashkëlidhur vendimit të Këshillit të Ministrave nr._____,

datë ____/____/____, mbaj numrin rendor_____.

Kërkuesi

(emri,atësia,mbiemri)

Shënim: Ky formular është dokument zyrtar. Paraqitja e të dhënave të rreme ose fshehja e tyre passjell përjashtimin e menjëhershëm nga çdo procedurë të mëtejshme, si dhe përgjegjësi penale sipas ligjit.
--